REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
KËSHILLI

Nr. 2379/1 prot Koplik më: 04 / 09 /2025

VENDIM

Nr 31 , Datë 03 /09 / 2025

MBI PLANIN VENDOR TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE SHTATOR 2025-SHTATOR 2030.

Këshilli Bashkiak Malësi e Madhe në mbledhjen e datës 03.09.2025,bazuar në ligjin Nr 139 datë 17.12.2015 "Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore". Ligjit Nr.57 datë 18.07.2019 "Për asistencen Sociale në Republiken e Shqiperisë". Ligji Nr.9970 datë 24.7.2008 "Për Barazinë Gjinore në Shoqëri".

VENDOSI

1. Të miratojë Planin Vendor të veprimit për Barazinë Gjinore Shtator 2025- Shtator 2030.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55 pika 6 të ligjit nr. 139/2015 "Për Veteqeverisjen Vendore",

KRYETAR
Ilir Halaj

SEKRETAR
Emirjan Hasmujaj
Miratuar me 03.09.2025
Vota Pro 17
Vota Kunder 3
Vota Abstenim 8
Zbardhur me datë 04.09.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALËSI E MADHE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
SEKTORI I SHËRBIMEVE SOCIALE

Nr. 2378 Prot. Koplik, me 01.09.2025

PROJEKT-VENDIM

Lënda: Dërgim dokumentacioni **Nr.___ Date___/___/2025**

Mbi Planin Vendor te veprimit per Barazine Gjinore Shtator 2025 - Shtator 2030

Bazuar ne ligjin Nr.139 date 17.12.2015 "Per organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore". Ligjit nr.57, date dt. 18.07.2019, "Per asistencen Sociale ne Republiken e Shqiperise, Ligji Nr.9970, date 24.7.2008 "PËR BARAZINË GJINORE NË SHOQËRI".

PROPOZOJ:

1. Te miratoje Planin Vendor te veprimit per Barazine Gjinore Shtator 2025- Shtator 2030, bashkangjitur dokumentacioni perkates.

KRYETAR
TONIN MARINAJ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALËSI E MADHE

Adresa:Koplik-Qender *tel:021122650/2651* *e-mail:bashkiamalesiemadhe@hotmail.com*

BASHKIA MALESI E MADHE

PLANI I BARAZISE GJINORE 2025/2030

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA MALESI E MADHE

Ndërgjegjësimi i komunitetit për barazinë gjinore.

Fushat Prioritare të Veprimit ,

Pjesëmarrja dhe Përfaqësimi Politik ,

Kuota gjinore në Këshillin Bashkiak.

Trajnime për lidership për gratë dhe vajzat e reja.

Konsultime publike gjithëpërfshirëse.

Ekonomia dhe Punësimi Mbështetje për sipërmarrjet e grave me grante dhe kredi të buta. - Nxitja e punësimit të grave në turizëm, bujqësi dhe artizanat.

Fushata për pagë të barabartë për punë të barabartë.

Arsimi dhe Ndërgjegjësimi - Programe edukative mbi barazinë gjinore në shkolla. - Inkurajimi i vajzave në fusha STEM.

Trajnime për administratën vendore mbi barazinë gjinore.

Shëndeti dhe Mirëqenia

Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore për gratë në zonat rurale.

Mbështetje për nënat dhe familjet e reja.

Qendra komunitare për shëndetin riprodhues dhe këshillimin psikologjik.

Dhuna me Bazë Gjinore

Mekanizma për raportimin dhe mbrojtjen e viktimave.

Shërbime strehimi të përkohshëm për viktimat.

Bashkëpunim me policinë, shëndetësinë dhe OJF-të.

Mekanizmat e Zbatimit dhe Monitorimit

Krijimi i Njësisë për Barazinë Gjinore pranë Bashkisë.

Bashkia Malesi e Madhe filloi të shtojë numrin e Koordinatoreve Vendore kundër dhunës në familje edhe në nivel të Njësive Administrative. Ndërkohë që gjatë punës për përgatitjen e këtij Plani Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore, vendosi të bëjë ndarjen e pozicionit të Nëpunëses së Barazisë Gjinore nga ai i Koordinatores. Ndërkohë që Koordinatorja Vendore kundër dhunës në

dhe nëse ka një rregullore funksionimi për të garantuar përfshirjen gjinore gjatë hartimit të buxhetit dhe planifikimit të shërbimeve.

Në vijim u shqyrtua praktika e mbledhjes së të dhënave me ndarje gjinore për çdo shërbim vendor. U evidentua se për disa shërbime ekziston mbledhje e rregullt e të dhënave, ndërsa për të tjera ka nevojë për përmirësim të kapaciteteve administrative dhe metodave të raportimit. Po ashtu, u vlerësua nëse bashkia ka zbatuar ndonjëherë buxhetim me perspektivë gjinore dhe në çfarë mase janë alokuar fonde për aktivitete që kontribuojnë në barazinë gjinore. Kjo metodologj ka mundësuar jo vetëm një kuptim të qartë të sfidave gjinore në territorin e bashkisë, por edhe krijimin e një plani realist, të matshëm dhe të përshtatshëm me burimet dhe kontekstin lokal të qeverisjes vendore.

1. Popullsia

- Sipas Censusit 2011: 30,823 banorë
- Sipas Regjistrit Civil (2016): 53,918 banorë
- Dendësia: ~32 banorë/km² (2011),

2. Zhvillimi i Popullsisë

Viti	Popullsia
2001	36,700
2011	30,823
2020	28,222
2023	21,684

3. Strukturë gjinore dhe mosha (2023)

- Meshkuj: 10,879
- Femra: 10,805
- 0-14 vjeç: 2,957
- 15-64 vjeç: 13,793
- 65+ vjeç: 4,934

detyrueshme e statistikave gjinore, nga të gjitha organet shtetërore, si dhe ngritja e strukturave dhe mekanizmave institucionalë për çuarjen përpara të barazisë gjinore. Plotësimi i kuadrit nënligjor për zbatimin e këtij ligji, ndër të tjera edhe me VKM Nr. 465 datë 16.07.2012 "Për integrimin gjinor në programin buxhetor afatmesëm", i hapi rrugën jo vetëm planifikimit të objektivave të matshme gjinore në programet buxhetore të institucioneve qendrore, por edhe të gjitha hapave të mëtejshëm në drejtim të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor (BPGJ) në Shqipëri. Ndërsa me **Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"** u është vënë detyrim kryetareve/kryetarëve të bashkive që në emërimet e zëvendës kryetareve/kryetarëve të bashkive dhe emërimet e administratoreve/administratorëve të njësive administrative të zbatojnë dhe respektojë barazinë gjinore.

Ligji nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" parashikon për herë të parë detyrimin e subjekteve zgjedhore për të respektuar barazinë gjinore. Ky Kod parashikoi në disa dispozita të tij zbatimin e kuotave gjinore si në administratën zgjedhore, komisionet e nivelit të dytë dhe në përbërjen e trupit të zgjedhur legjislativ, Kuvendit. Kodi Zgjedhor vendosi detyrimin që në listën shumë-emërore të kandidateve/kandidatëve për deputete/deputetë të partive politike, për zgjedhjet për Kuvendin, asnjëra prej gjinive nuk mund të përfaqësohej me më pak se 30%. Kjo do të garantohej nga përfshirja në listat shumë-emërore të kandidateve/kandidatëve të paraqitur nga partitë politike për zgjedhjet për Kuvendin, për çdo zonë zgjedhore, e kriterit të kuotës gjinore sipas të cilit të paktën tridhjetë përqind dhe/ose një në tre emrat e parë duhet t'i përkasë secilës gjini. Me amendimet që iu bënë këtij Kodi në vitin 2015, u vendos kuota 50% burra dhe 50% gra në listat e kandidateve/kandidatëve për këshilltaret/këshlltarët në zgjedhjet vendore. Ndërsa me amendimet e vitit 2020, me **Ligjin nr. 101/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,** u përfshi koncepti i "gjinisë së nënpërfaqësuar" (gjinia me tradicionalisht numrin më të vogël të anëtareve/anëtarëve në Kuvend ose, sipas rastit, në këshillat vendorë në rang vendi), si dhe u saktësuan përcaktimet mbi lirinë zgjedhore dhe barazinë gjinore në nenin 4 të këtij Kodi.

Ligji Nr. 57/2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, përfshin për herë të parë konceptin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në menaxhimin e sistemit buxhetor, duke shtuar si parim të funksionimit të tij respektimin e barazisë gjinore, ku burri dhe gruaja gëzojnë mundësi dhe

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALËSI E MADHE

Ligji Nr.104/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, e dreja e lejës për kujdesin ndaj fëmijës iu njoh edhe babait, pas periudhës prej 63 ditësh pas lindjes së fëmijës dhe kur këtë të drejtë nuk e ushtron ose nuk ka kushte për ta përfituar nëna. Për gratë shtatzëna është shtuar periudha e ndalimit të punës pas lindjes nga 42 ditë (që ishte përpara miratimit të ndryshimit ligjor) në 63 ditë. Parashikime të tjera në këtë ligj janë bërë edhe për rikthimin e nënës në vendin e punës pas 63 ditëve me dëshirën e saj dhe përshtatjen e gjendjes së saj me kushtet e punës, ushqimin me gji të fëmijës, etj. Me VKM Nr. 740, datë 12.12.2018 "Për përcaktimin e ndihmës së menjëhershme financiare për nënat me foshnja të porsalindura dhe procedurën për dhënien e tij", hyri në fuqi më 1 janar 2019 aplikimi i bonusit për nënat me foshnja të porsalindura, që varion nga 40,000 mijë lekë për fëmijën e parë në 80,000 lekë për fëmijën e dytë dhe 120,000 mijë lekë për fëmijën e tretë. Këtë bonus e përfitojnë edhe nënat që i lindin fëmijët e tyre jashtë vendit me kushtin që fëmija të regjistrohet sipas afateve ligjore.

Në mënyrë të veçantë për çështjet e dhunës në familje dhe mosdiskriminimit përmendim:

Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar. Qëllimi i ligjit është që të parandalojë dhe zvogëlojë dhunën në familje në të gjitha format e saj dhe të mbrojë viktimat përmes një procedure të shpejtë, të përballueshme dhe të thjeshtë. Dy përmirësimet më të rëndësishme të këtij ligji datojnë në vitet 2018 dhe 2020. **Ligji 47/2018 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare",** përmbushi rekomandimet e dhëna nga Komiteti CEDAW (2016) dhe nga GREVIO (2017). Nëpërmjet ndryshimeve të bëra, u forcuan masat mbrojtëse dhe proceduriale për një përgjigjje më efektive ndaj dhunës në familje dhe mbrojtja e viktimave, përmes lëshimit të Urdhrit për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme, i paraprirë nga vlerësimi i riskut, për çdo rast që trajtohet. Gjithashtu, për herë të parë, mbrohen gratë dhe vajzat në marrëdhënie intime, pa pasur lidhje formale me dhunuesit, si martesa ose bashkëjetesa.<u>Në detyrim të ligjit Nr. 47/2018, janë miratuar katër Udhëzime:</u>

- ✓ Udhëzimi Nr. 816, datë 27.11.2018, i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale "Për miratimin e standarteve të ofrimit të shërbimeve dhe të funksionimit të Qendrave të menaxhimt të krizës për rastet e dhunës seksuale",

nxënëseve/nxënësve dhe punonjëseve/punonjësve u ofrohet mbrojtje nga çdo formë veprimi ose mosveprimi që mund t'u shkaktojë diskriminim, dhunë, keqtrajtim ose dëm moral".

Gjatë periudhës 2016 – 2020 janë miratuar apo përmirësuar edhe një sërë ligjesh të tjera, ku është theksuar parimi i barazisë gjinore apo mbrojtja nga dhuna dhe diskriminimi, siç mund të përmendim:

Ligji 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" ku parimi i mosdiskriminimit për një tërësi shkaqesh, duke filluar nga gjinia, renditet në parimet bazë për ofrimin e shërbimeve. Ligji gjithashtu parashikon ofrimin e shërbimeve të specializuara për gratë dhe vajzat e dhunuara apo të trafikuara, për gratë dhe vajzat shtatzëna ose prind i vetëm me fëmijë deri në 1 vjeç, etj.

Ligji 65/2016 "Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë" që ndër të tjera synon punësimin e personave të pafavorizuar në tregun e punës, si: personat që trajtohen me ndihmë ekonomike, personat me aftësi të kufizuara, jetimet/jetimët, gratë viktima të dhunës dhe trafikimit, etj.

Ligji 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë" që përmirëson qasjen e viktimave në informacion përmes vendosjes së një koordinatori/koordinatoreje për marrëdhëniet me publikun në secilën prokurori, përgjegjës/përgjegjëse për informimin e viktimave.

Ligji 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", ku barazia dhe mosdiskriminimi përmenden që në parimet e përgjithshme të tij. Ligji përcakton se *çfarë do të thotë mbrojtje e fëmijës, duke qartësuar "ma*sat e mbrojtjes" që mund të aplikojnë punonjësit/punonjëset kur konstatojnë raste të fëmijëve në situatë të pasigurt për shkak të dhunës, abuzimit, neglizhimit apo shfrytëzimit. Për herë të parë parashikohet mbrojtja e fëmijëve në situatë rruge apo që punojnë/shfrytëzohen për punë, adresimi i formave të ndryshme të dhunës ndaj fëmijëve, si bulizmi, dhuna në shkolla, në familje, abuzimi seksual, shfrytëzimi ekonomik, siguria e fëmijëve në internet, fëmijët e pashoqëruar ose viktima të trafikimit, etj.

Ligji 22/2018 "Për strehimin social", ku theksohet parimi i mosdiskriminimit, për planifikimin, pajisjen, shpërndarjen dhe menaxhimin e strehimit për grupet sociale në nevojë për strehim. Nga programi i banesave të specializuara përfitojnë shtresat vunerabël përfshirë viktimat e trafikimit, dhunës në familje dhe vajzat nëna.

Ligji 110/2018 "Për noterinë", që fuqizon pavarësinë ekonomike të gruas dhe është garant kryesor i të drejtave pronësore të saj, duke sjellë risi në çështjet e rregullimit të barazisë gjinore në aspektin e mbrojtjes së pasurive.

Ligji 111/2018 "Për kadastrën", që gjithashtu rregullon çështjet e barazisë gjinore, lidhur me regjistrimin e pasurisë së bashkësisë ligjore.

Ligji 15/2019 "Për nxitjen e punësimit", ku viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit, dhunës me bazë gjinore, dhunës në familje apo nënat nën moshën 18 vjeç, specifikohen tek grupet e veçanta të punëkërkueseve/punëkërkuesve të disavantazhuar në tregun e punës, të cilat/cilët përfitojnë nga shërbimet dhe programet e nxitjes së punësimit.

Ligji 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" ku përcaktohen si përfituese/përfitues të ndihmës ekonomike ndër të tjera viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore, deri në çastin e punësimit të tyre si dhe viktimat e dhunës në familje, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrit të mbrojtjes ose urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, të cilat nuk trajtohen në institucionet e përkujdesjes shoqërore.

Ligji 34/2019 "Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara", ku theksohet mirëadministrimi dhe përdorimi efiçent, efektiv dhe ekonomik i pasurive të sekuestruara e konfiskuara nga organet e drejtësisë dhe pasurive të sekuestruara me urdhër të ministrit përgjegjës për financat, rikthimi në komunitet i pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme dhe kompensimi financiar i viktimave të krimit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE

Barazisë Gjinore dhe **Sektorit të Politikave dhe Strategjive për Përfshirjen Sociale dhe Barazinë Gjinore,** si pjesë e Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Sipas Ligjit nr. 9770, datë 24.07.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri", nenet 11 dhe 12, **Këshilli Kombëtar për Barazinë Gjinore** (KKBGJ) është organi më i lartë këshillues për çështjet e barazisë gjinore dhe sigurimin e integrimit gjinor në të gjitha fushat, veçanërisht në çështjet politike, sociale, ekonomike dhe kulturore. Këshilli ngrihet me Urdhër të Kryeministrit dhe rinovohet një herë në katër vjet. KKBGJ drejtohet nga Ministrja e MSHMS dhe në përbërje ka 9 përfaqësuese / përfaqësues të ministrive të linjës në rang zëvendësministreje / zëvendësministri dhe drejtuesesh / drejtuesish të lartë, si dhe tre përfaqësuese / përfaqësues të shoqërisë civile, të cilat / cilët zgjidhen mbi bazën e një konkurimi të hapur, duke patur si kriter eksperiencën dhe kontributin për këto çështje.

Institucionet shtetërore në nivel qendror dhe vendor kanë detyrimin ligjor të bashkëpunojnë me ministren/ministrin përkatës që mbulon çështjet e barazisë gjinore për të shkëmbyer informacion dhe për të lehtësuar përmbushjen e funksionit të saj/tij. Për këtë qëllim, **në çdo ministri** është caktuar një **nëpunëse/nëpunës i barazisë gjinore (NBGJ)** që ka për detyrë adresimin e çështjeve të barazisë gjinore dhe në **secilën bashki** emërohen një ose më shumë punonjëse/punonjës vendorë të barazisë gjinore.

Urdhëri i Kryeministrit Nr.32, datë 12.02.2018 "Për përcaktimin e koordinatorit kombëtar për barazinë gjinore" ka përcaktuar Zëvendëskryeministrin koordinator kombëtar për barazinë gjinore, i cili autorizohet të fuqizojë mekanizmin për barazinë gjinore në nivel qendror dhe të ndërmarrë rol koordinues.

Në nivelin e Kuvendit të Shqipërisë, në datë 4 dhjetor 2017, u miratua rezoluta "Për dënimin e dhunës ndaj grave e vajzave dhe rritjen e efektshmërisë së mekanizmave ligjorë për parandalimin e saj". Në zbatim të angazhimeve të marra në këtë rezolutë dhe bazuar në nenin 19 të Rregullores, me vendimin e Kuvendit nr. 113/2017, datë 4 dhjetor 2017 u miratua ngritja e ***Nënkomisionit "Për barazinë gjinore dhe parandalimin e dhunës ndaj gruas"***, pranë Komisionit të përhershëm për

BASHKIA MALËSI E MADHE

Monitorimi dhe raportimi Zbatimi i Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2025–2030 do të shoqërohet nga një sistem i dedikuar monitorimi dhe raportimi, i cili siguron ndjekjen në kohë reale të progresit, evidentimin e sfidave dhe përmirësimin e vazhdueshëm të veprimeve të ndërmarra. Ky sistem do të bazohet në një qasje të kombinuar: institucionale, participuese dhe të bazuar në të dhëna. Monitorimi dhe Raportimi Zbatimi i Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2025–2030 do të shoqërohet nga një sistem i dedikuar monitorimi dhe raportimi, që siguron: Ndjekje në kohë reale të progresit; Evidentim të shpejtë të sfidave; Përmirësim të vazhdueshëm të veprimeve. Qasja dhe parimet e monitorimit Monitorimi do të jetë: i strukturuar, me përgjegjësi të qarta për çdo njësi zbatuese; i bazuar në tregues të matshëm, të përcaktuar për çdo aktivitet; i hapur ndaj pjesëmarrjes së komunitetit dhe aktorëve jo publikë, për të garantuar transparencën dhe përfshirjen. Aktorët përgjegjës Koordinatori për barazinë gjinore do të luajë rolin koordinues dhe teknik për grumbullimin dhe analizën e të dhënave. Komisioni për Barazinë Gjinore në Bashki (KBGJ) do të ndjekë progresin në nivel strategjik dhe do të raportojë në Këshillin Bashkiak. Drejtoritë dhe njësitë zbatuese përkatëse janë përgjegjëse për dërgimin periodik të informacionit mbi zbatimin e aktiviteteve. Treguesit e progresit Për secilin aktivitet në plan janë përcaktuar tregues të qartë si: numri i trajnimeve të realizuara, pjesëmarrja gjinore në aktivitete, numri i strukturave të ngritura, përfshirja e komunitetit në 40 konsultime, etj. Treguesit janë ndarë sipas gjinisë dhe, aty ku është e mundur, sipas grupmoshës, nivelit arsimor, punësimit, statusit martesor dhe zonës (urbane/rurale). Formatet e raportimit Raportimi do të realizohet çdo 6 muaj, përmes një formati të thjeshtuar të mbledhjes së të dhënave dhe analizës gjinore, që do të përdoret nga të gjitha drejtoritë dhe njësitë administrative. Çdo vit, përmes një raporti të përmbledhur vjetor mbi progresin e Planit, i cili do të publikohet në faqen e internetit të bashkisë dhe do t'u prezantohet këshilltarëve dhe komunitetit. Raporti vjetor do të përmbajë analiza të të dhënave, shembuj praktikë nga territori, si dhe rekomandime për përmirësim të mëtejshëm. Mbledhja e të dhënave, analiza dhe dixhitalizimi Në vitin e parë të zbatimit, Bashkia do të krijojë një Regjistër Dixhital për Monitorimin e Barazisë Gjinore, i cili do të përfshijë mbledhjen sistematike të të dhënave statistikore të ndara sipas gjinisë dhe indikatorëve të progresit të Planit Vendor 2025–2028. Kjo nismë do të zbatojë praktikat më të mira për publikimin e të dhënave ne menyre trasparente dhe te kuptueshme. Vlerësimi ndërmjetës dhe përfundimtar Në fund të vitit 2027 do të realizohet një vlerësim ndërmjetës, për të analizuar ritmin e zbatimit dhe për të bërë rregullime në plan, nëse është e nevojshme.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR

Kostot e paraqitura janë orientuese dhe miratimi i këtij Plani Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2025 - 2030, të kostuar, nuk nënkupton automatikisht edhe buxhetimin e tij. Për të buxhetuar dhe alokuar fondet përkatëse të përvitshme, pa të cilat zbatimi i këtij PVVBGJ nuk merr jetë, Bashkia duhet të përfshijë në parashikimet buxhetore vjetore dhe afatmesme edhe masat e parashikuara në të. Në këtë kuadër edhe mbështetja dhe lobimt nga vetë gratë këshilltare për sigurimin e burimeve financiare për realizimin e aktiviteteve/ masave, përmes përfshirjes së tyre në buxhete vjetore apo afatmesme të Bashkisë, është domosdoshmëri.

Me rishikimin e përvitshëm të Planit Vendor të Veprimit, ***duhet bërë patjetër edhe rishikimi i kostove të propozuara,*** bazuar edhe në mënyrën e përfshirjes së tyre në buxhetet vjetore apo PBA-të e Bashkisë, si dhe në marrëveshjet me donatorët apo partnerët e mundshëm. Kjo kërkon një vëmendje të shtuar sidomos në periudhën e përgatitjes së PBA-ve dhe buxheteve vjetore, përtë përfshirë nëto masat dhe veprimete parashikuara në matricën e PVVBGJ, sipas ndarjeve në vite.

Nga përllogaritjet e bëra rezulton se kostot në tërësi për zbatimin e PVVBGJ 2025 - 2030 janë në vlerën 28,751,711 lekë. Nga këto:

10,749,321 lekë janë kosto për zbatimin e fushës së ndërhyrjes I "Promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, si dhe fuqizimi i vajzave, të rejave dhe grave, në të gjithë diversitetin e tyre".

843,198 lekë janë kosto për zbatimin e fushës së ndërhyrjes II "Rritja e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grave dhe të rejave e të rinjve, në të gjithë diversitetin e tyre, në vendimmarrjen politike apo publike në nivelin vendor".

14,967,602 lekë janë kosto për zbatimin e fushëssë ndërhyrjes III "Liri nga të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe dhunës në familje".

2,191,570 lekë janë kosto për zbatimin e fushës së ndërhyrjes IV "Integrimi gjinor në politikat vendore".

Në totalin e kostos **28,751,711 lekë** të nevojshme për zbatimin në tërësi të PVVBGJ 2025-2027 përtë gjithë kohëzgjatjen e tij:

16,862,023 lekë janë ***kosto që do të mbulohen nga Bashkia*** (me stafin ekzistues dhe me kontribut në natyrë - salla, mjete, etj.), pra ***të cilat nuk kanë nevojë të përllogariten si shtesë në buxhet, sepse edhe burimet njerëzore edhe infrastrukturore ekzistojnë.***

10,429,522 lekë janë ***kosto që mbulohen nga donatorë*** të ndryshëm (të cilët kanë dakordësuar paraprakisht gjatë përgatitjes së draft PVVBGJ-së).

dhunës në familje.	Referimit kundër dhunës në familje.				
	III.2. Zvogëlimi i steriotipeve gjinore, praktikave të dëmshme, diskriminimit dhe disavantazhimit të shumëfishtë, përmes edukimit të shoqërisë me parimet e	4,984,184 lekë	4,235,784 lekë	129,000 lekë	619,400 lekë
	III.3. Fuqizimi i grave, të rejave dhe të rinjve për ndërtimin e komuniteteve të sigurta, përmes promovimit të Agjendës "Gruaja, Paqja dhe Siguria" dhe Agjendës "Rinia, Paqja dhe	2,440,000 lekë	2,374,600 lekë	0 lekë	65,400 lekë
Gjithsej Objektivi strategjik III:		**19,967,602 lekë**	**14,130,502 lekë**	**152,300 lekë**	**684,800 lekë**
4. Integrimi gjinor në politikat vendore.	IV.1. Rritja e përgjegjshmërisë dhe transparencës së bashkisë në përmbushjen e angazhimeve publike për	398,250 lekë	278,250 lekë	0 lekë	120,000 lekë
	IV.2. Zbatlmi i detyrimeve për integrimin gjinor dhe buxhetimin e përgjigjshëm gjinor në nivel	1,793,320 lekë	1,673,320 lekë	0 lekë	120,000 lekë

. MATRICA E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2025 - 2030

Fusha e ndërhyrjes (Objektivi strategjik):	**1. PROMOVIMI 1 TË DREJTAVE EKONOMIKE, SOCIALE DHE TË PUNËSIMITTË DENJË, SI DHE FUQIZIMI 1 VAJZAVE, TË REJAVE DHE GRAVE, NË TË GJITHË DIVERSITETIN E TYRE.**
Rezultatet e pritshme:	I.a. Veprimet e bashkisë për të nxitur rritjen e punësimit dhe fuqizimin ekonomik të grave etë rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, të përmirësuara ndjeshëm. I.b. Masat që synojnë nxitjen e sipërmarrjes së grave dhe të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, të përshtatura me nevojat e tyre specifike.
Dokumentet kryesore që u referohemi:	- Karta Evropiane për Barazi të grave dhe burrave në jetën vendore - nenet 11, 17, 27. - Konventa për Eliminimin e të gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) - nenet 11, 12, 13. - Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit (BDPfA) -fusha kritike 6. - Konventa e KE për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) - neni 12/6. - Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore i BE (EU GAP III) - shtylla III, fushat kryesore tematike 3.3, 3.6. - Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore (SKBGJ) 2021 - 2030 - objektivat specifikë 1.1, 1.2,1.3.
Objektivi specifik:	**1.1. Rritja e aksesit të grave dhe të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, ndaj shërbimeve, produkteve dhe burimeve financiare që ndikojnë në fuqizimin ekonomik dhe përmirësimin e situatës ekonomike të tyre.**

Treguesit:	**Baseline: (2025)**	**Target: (2027)**	**MONITORIMI**
1.1.a. Numri i grave dhe të rejave përfituese nga aktivitetet e fuqizimit të kapaciteteve (trajnime dhe programe të formimit profesional), ndarë sipas moshës, përkatësisë etnike-kulturore, aftësisë së kufizuar, vendbanimit, llojit të aftësive të përfituara (llojit të trajnimit), etj.	Do përcaktohet	Rritur me 4% (2% çdo vit)	Komisioni për Barazi Gjinore në nivel bashkie / Grupi i Monitorimittë PVVBGJ;
1.1.b. Numri i sipërmarrjeve të reja, të themeluara ose të drejtuara nga gratë dhe të rejat, të cilat kanë marrë mbështetje financiare nga bashkia gjatë periudhës së zbatimit të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ), e ndarë sipas sektorëve (biznes, bujqësi, turizëm, teknologji, etj.).	Do përcaktohet	Rritur me 2.5% (0.5% çdo vit)	Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Përfshirjes Sociale, si dhe anëtaret/anëtarët e Këshillit Bashkiak.

MASAT DHE AKTIVITETET	**ZBATIMI**		**AFATI KOHOR**	**TREGUES**	**KOSTO (LEKË)**		
	Përgjegjës kryesor	**Mbështetës**			**2025**	**2026**	**2027**

				moshës, vendbanimit, etnisë, etj.			
1.1.5, Referimi në Zyrën e Punës i rasteve të grave dhe burrave në skemën e ndihmës ekonomike, apo të grave, të rejave e të rinjve viktima/të mbijetuara/mbijetuartë dhunës me bazë gjinore, për të përfituar nga programet e nxitjes së punësimit (6 muaj -1 vit) dhe formimit profesional.	Sektori i Kujdesit Social	AKPA	2025 2027	Numri i rasteve të referuara në vit, ndarë sipas seksit, moshës, etnisë, vendbanimit, grupit social, etj. Numri i personave që kanë përfituar nga programet e nxitjes së punësimit	21,332 lekë (bash kia)	21,332 lekë (bashkia)	21,332 lekë (bashkia)
1.1.6. Ndërmjetësimi i grave dhe të rejave/rinjve të cilat / cilët kanë një ide biznesi, me organizatat e Start Stop, të cilët financojnë fazën fillestare të jetësimit/ngritjes së këtyre bizneseve.	Sektori i Këshillimit të Shërbimeve	Sektori i Kujdesit Social, OJF, organizatat ndërkombëtare	2025 2027	Numri i personave të ndërmjetësuar në vit, ndarë sipas seksit, moshës, etnisë, vendbanimit, grupit social, etj. seksit, moshës, etnisë, vendbanimit, grupit social, etj.	Kosto e përfshirë në aktivitetet 1.1.4 dhe 1.1.5 më sipër	Kosto e përfshirë në aktivitetet 1.1.4 dhe 1.1.5 më sipër	Kosto e përfshirë në aktivitetet 1.1.4 dhe 1.1.5 më sipër
1.1.7. Takime informuese me nxënëse dhe nxënës të shkollave nëntë vjeçare dhe të mesme mbi thyerjen e steriotipeve gjinore në punësim, si dhe shërbimet e punësimit dhe formimit profesional që ofrohen nga AKPA (përfshirë dhe programet e vetëpunësimit, mbulimin e	Sektori i Arsimit dhe Sporteve	ZVA, Shkollat, NJA, AKPA	2025 2027	të paktën tetë takime në vit (1 në çdo NJA) Numri i personave të informuar ndarë sipas seksit,	46,000 lekë (nga të cilat 40,000 lekë bashkia dhe 6,000 lekë hendek financiar)	46,000 lekë (nga të cilat 40,000 lekë bashkia dhe 6,000 lekë	46,000 lekë (nga të cilat 40,000 lekë bashkia dhe 6,000 lekë

1.1.12. Organizimi i kurseve përguidat turistike duke nxitur pjesëmarrjen e të rejave dhe grave në këto kurse	Sektori i Turizmit dhe Mjedisit	AKPA, NJA, OJF, organ izatat ndërkombëtare	2026 2027	1 guidë në vit Numri i pjesëmarrës/eve ndarë sipas seksit, moshës, etnisë, vendbanimit, etj.	N/a	145,000 lekë (hendek financiar)	145,000 lekë (hendek financiar)
1.1.13. Trajnime për rritjen e aftësive të grave dhe të rejave në sektorë të rëndësishëm të ekonomisë (bujqësi, sipërmarrje, etj.).	Sektori i Këshillimit të Shërbimeve dhe Sektori i Turizmit dhe Mjedisit	AKPA, NJA, OJF, organizatat ndërkombëtare	2026 2027	1 trajnim në vit Numri i pjesëmarrëseve ndarë sipas moshës, etnisë, vendbanimit, etj.	N/a	31,998 lekë (nga të cilat 27,915 lekë bashkia dhe 4,083 lekë donatorë)	31,998 lekë (nga të cilat 27,915 lekë bashkia dhe 4,083 lekë donatorë)
1.1.14. Trajnimi i punonjëseve/punonjësve të administratës publike mbi Konventën C190 të ONP-së mbi dhunën dhe ngacmimet në botën e punës.	Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Koordinatori i Projekteve me BE-në	Sektori i Kujdesit Social, AKPA, OJF, organizatat ndërkombëtare	2026 2027	1 trajnim në vit Numri i personave ndarë sipas seksit, moshës, pozicionit, etj.	N/a	38,750 lekë (nga të cilat 18,750 lekë bashkia dhe 20,000 lekë hendek financuar)	38,750 lekë (nga të cilat 18,750 lekë bashkia dhe 20,000 lekë hendek financuar)
1.1.15. Rishikimi Kadit Etik dhe përfshirja në të e një politike të veçantë për ngacmimin seksual në vendin e punës, dhe mekanizmin e raportimit dhe ndjekjes së tij (në përputhje edhe me masat në Konventën C190 të ONP-së)	Sektori Juridik dhe i Prokurimeve Publike	Sektori i Kujdesit Social, Sektori i Burimeve Njerëzore, Koordinatori i Projekteve me BE-në	2027	Kodi i rishikuar dhe politika e shtuar	N/a	N/a	2,027 lekë (bashkia)
1.1.16. Rishikimi ligjor i kuadrit normativ për barazinë gjinore dhe zhvillimin rural, duke integruar perspektivën gjinore dhe fushata ndërgjegjësuese dhe edukative	Sektori i Pronave	Sektori i Këshillimit të Shërbimeve, Njësitë	2026 2027	Gjetjet nga rishikimi	N/a	53,330 lekë (donatorë)	53,330 lekë (donatorë)

II.I.b. Përqindja e grave dhe të rejave drejtuese, në të gjithë diversitetin e tyre, në strukturat vendimmarrëse në Bashki, Këshillin Bashkiak, Njësitë Administrative, Këshillat e Fshatrave, etj.	Do përcaktohet	Rritur në përpuzhje me legjislacionin në fuqi	Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Përfshirjes Sociale, si dhe anëtaret/anëtarët e Këshillit Bashkiak.

MASAT DHE AKTIVITETET	ZBATIMI		AFATI KOHOR	TREGUES	KOSTO (LEKË)		
	Përgjegjës kryesor	Mbështetës			2025	2026	2027
II.1.1, Takime motivuese për nxitjen e pjesëmarrjes së grave dhe të rejave në vendimmarrje, të organizuara me praninë e vetë grave dhe të rejave që janë aktualisht në pozicione vendimmarrëse.	Sektori i Sherbimeve Sociale	Njësitë Administrative, Komisioni për Barazi Gjinore, OJF, organizatat ndërkombëtare	2025 2027	2 takime në vit Numri i grave dhe të rejave të përfshira në çdo takim, ndarë sipas moshës, vendbanimit, etnisë, etj.	7,166 lekë (bashkia)	7,166 lekë (bashkia)	7,166 lekë (bashkia)
II.1.2. Trajnim i Aleancës së Grave Këshilltare (AGK) dhe Komisionit të Barazisë Gjinore (KBGJ) në lidhje me përfaqësimin, lidershipin, vendimmarrjen dhe barazinë gjinore.	Sektori i Sherbimeve Sociale	Njësitë Administrative, KBGJ, OJF, organizatat ndërkombëtare	2025 2027	1 trajnim në vit Numri i të trajnuarave, ndarë sipas pozicionit, etj.	99,500 lekë (donatorë)	99,500 lekë (donatorë)	99,500 lekë (donatorë)
11.1.3. Përmirësimi i rregullores për fuqizimin e Këshillit Vendor Rinor duke shtuar në anëtarësinë e tij të reja dhe të rinj edhe nga grupet e pa favorizuara, si dhe duke respektuar barazinë gjinore në përfaqësim në këtë këshill.	Sektori i Sherbimeve Sociale	Kabineti i Kryetares	2026 2027	Rregullorja e përmirësuar Numri i anëtareve/anëtarëve të shtuar në KVR sipas parimeve të BGJ dhe gjithëpërfshirjes	**N/a**	50,500 lekë (nga të cilat 32,500 lekë bashkia dhe 18,000 lekë donatorë)	50,500 lekë (nga të cilat 32,500 lekë bashkia dhe 18,000 lekë donatorë)
III.1.4. Trajnime të të rejave dhe të rinjve, në të gjithë diversitetin e tyre, për formimin e aftësive udhëheqëse dhe drejtuese, si dhe adresimin në mënyrën e duhurtë barazisë gjinore në vendimmarrje.	Sektori i Sherbimeve Sociale	OJF, organizatat ndërkombëtare	2025 2027	1 trajnim në vit Numri i të rejave e të rinjve të përfshirë,	99,500 lekë (nga të cilat 11,500 lekë bashkia,	89,500 lekë (nga të cilat 11,500 lekë bashkia, 28,000	89,500 lekë (nga të cilat 11,500 lekë bashkia, 28,000

Rezultatet e pritshme:	III.a. Mekanizmi i Koordinuar të Referimit kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, i fuqizuar dhe efi-cas. III.b. Një brez i ri i barazisë, që lufton steriotipet gjinore, praktikat e dëmshme dhe diskriminimin apo disavantazhimin e shumëfishtë, i krijuar dhe fuqizuar. III.c. Veprimet e bashkisë për ndërtimin e komuniteteve të sigurta, të paqta e gjithëpërfshirëse, të përmirësuara ndjeshëm.
Dokumentet kryesore që u referohemi:	- Karta Evropiane për Barazi të grave dhe burrave në jetën vendore (EU Charter for Equality) - nenet 6, 10, 13, 16, 20, 21, 22, 23. - Konventa për Eliminimin e të gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) - nenet 2, 5, 6, 10, 16. - Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit (BDPfA) -fusha kritike 2, 9. - Konventa e KE për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) - nenet 1/b, 4/2, 4/3, 12/1, 7, 8, 11, 12/6, 13, 14, 16, 17, 19, 22, 23, 50, 51, 52, 53, etj. - Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore i BE (EU GAP III) - objektivi specifik tematik 2, shtylla III, fusha kryesore tematike 3.1, 3.5. _Agjenda "Gruaja, Paqja, Siguria" dhe Agjenda "Rinia, Paqja, Siguria". - Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore (SKBGJ) 2021 - 2030 - fusha e ndërhyrjes III, objektivi specifik III.2.III.4.
Objektivi specifik:	**III.I. Fuqizimi dhe rritja e efikasitetit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit kundër dhunës në familje.**

Treguesit:	**Baseline: (2025)**	**Target: (2027)**	**MONITORIMI**
III.I.a. Numri i rasteve të dhunës në familje të denoncuara dhe të trajtuara nga MKR, krahasuar me numrin total të rasteve të dhunës në familje të regjistruara nga Bashkia.	Do përcaktohet	Rritur me 2% (1% çdo vitj	Komisioni për Barazi Gjinore në nivel bashkie / Grupi i Monitorimit të PVVBGJ; Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Përfshirjes Sociale, si dhe anëtaret/anëtarët e Këshillit Bashkiak.
III.I.b. Përqindja e buxhetit të bashkisë dedikuar shërbimeve mbështetëse të specializuara për rastet e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.	Do përcaktohet	Rritur me *2%* (1% çdo vitj	

MASAT DHE AKTMTETET	**ZBATIMI**		**AFATI KOHOR**	**TREGUES**	**KOSTO (LEKË)**		
	Përgjegjës kryesor	**Mbështetës**			**2025**	**2026**	**2027**
III.1.1. Ri nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit për funksionimin e MKR Bulqizë dhe përfshirja e komuniteteve fetare si anëtarë të MKR	Sektori i Kujdesit Social	Anëtarët e MKR Bulqizë	2025 (sipas nevojës	Marrëveshja e ri nënshkruar	23,300 lekë (donatorë)	N/a	N/a

III.1.7. Vazhdimi i monltorimit të rregullttë zbatimit tëUM	Sektori i Kujdesit Social	Anëtarët e MKR	2025 2027 2028	Numri i raporteve të monitorimit të përgatitura dhe dorëzuara në polici, për çdo rasttë monitoruar	19,248 lekë (bashkia)	19,248 lekë (bashkia)	19,248 lekë (bashkia)
III.1.8. Përditësimi i databazës rregullisht (REVALB) dhe ndarja e të dhënave me anëtarët e MKR sipas kërkesës	Sektori i Kujdesit Social	Anëtarët e MKR	20252029 2027	Data baza e përditësuar rregullisht	79,560 lekë (bashkia)	79,560 lekë (bashkia)	79,560 lekë (bashkia)
III.1.9. Mbështetje e drejtpërdrejtë përtë mbijetuarat, përmes zhvillimit dhe/ose zbatimit të aktiviteteve përtë siguruar ri integrimin socio- ekonomik afatshkurtër dhe afatgjatë të të mbijetuarave të dhunës.[24]	Sektori i Kujdesit Social	Anëtarët e MKR, Ministritë e linjës, OJF, organizatat ndërkombëtare	2025 *2027*	Numri i aktiviteteve që sigurojnë ri integrimin të zhvilluara nëvit. Numri i të mbijetuarave të dhunëstë mbështetura, ndarë sipas moshës, vendbanimit, llojit të dhunës së ushtruar, llojit të shërbimit të ri integrimit, etj.	1,041,667 (donatorë)	1,041,667 (donatorë)	1,041,667 (donatorë)
III.1.10. Kostimi[25] i menaxhimittë një rasti të dhunës në familje për të gjitha veprimet që duhet të ndërmarrë bashkia në bazë të legjislacionit në fuqi, dhe sigurimi i mjeteve financiare të nevojshme vit pas viti, përmes parashikimittë tyre në buxhetin e bashkisë, bazuar në këtë kostim.	Sektori i Kujdesit Social	Sektori i Buxhetit, OJF, organizatat ndërkombëtare	2025 2027	Kostimi i realizuar dhe gjetjet e përfshira në buxhetet vjetore të bashkisë	Kosto për kostimin do mbulohet nga donatorët	Kosto për kostimin do mbulohet nga donatorët Kosto për t'u oërfshirë në	Kosto për kostimin do mbulohet nga donatorët Kosto përt'u përfshirë në

				Numri i rasteve të referuara në këto shërbime në përputhje me marrëveshjen		sipas marrëveshjes	sipas marrëveshjes
III.1.15. Trajnimi I stafit të Njësive Administrative mbi mënyrën e identifikimit dhe referimit të rasteve të dhunës me bazë gjinore në MKR Bulqizë	Sektori i Kujdesit Social	OJF, organizatat ndërkombëtare	2026 2027	1 trajnim në vit Numri i personave të trajnuar ndarë sipas seksit, pozicionit, etj.	N/a	99,600 lekë (nga të cilat 39,600 lekë bashkia dhe 60,000 lekë hendek financiar)	99,600 lekë (nga të cilat 39,600 lekë bashkia dhe 60,000 lekë hendek financiar)
III.1.16. Shtimi në strukturën e bashkisë i një person! të dedikuar me kohë të plotë vetëm si PMF	Sektori i Burimeve Njerëzore	Sektori i Kujdesit Social, Sektori i Buxhetit	2026 2027	Pozicioni i shtuar	N/a	1,065,660 lekë (bashkia)	1,065,660 lekë (bashkia)
III.1.17. Trajnime të personelit shëndetësor mbi barazinë gjinore dhe dhunën me bazë gjinore	Sektori i Kujdesit Social	NJVKSH, OJF, organizatat ndërkombëtare	2025 2027	1 trajnim në vit Numri i personave të trajnuar ndarë sipas seksit, pozicionit, etj.	23,000 lekë (bashkia)	23,000 lekë (bashkia)	23,000 lekë (bashkia)
Objektivi specifik:	**III.2. Zvogëlimi i steriotipeve gjinore, praktikave të dëmshme, diskriminimit dhe disavantazhimit të shumëfishtë, përmes edukimit të shoqërisë me parimet e barazisë gjinore.**						
	Treguesit:			**Baseline: (2025)**		**Target: (2027)**	**MONITORIMI**

(përfshirë dhunën kibernetike, femicidin, trafikimin e qenieve njerëzore, etj.)				seksit, moshës, vendbanimit, etj.	42,000 lekë hendek financiar)	42,000 lekë hendek financiar)	42,000 lekë hendek financiar)
III.2.4. Organizimi i Fushatës së 16 Ditëve të Aktivizmit kundër DHBGJ	Sektori i Kujdesit Social	Anëtarët e MKR , Ministritë e linjës, OJF, organizatat ndërkombëtare	2025 2027	Njëfushatë nëvit	75,000 lekë (nga të cilat 35,000 lekë bashkia dhe 40,000 lekë hendek financiar)	75,000 lekë (nga të cilat 35,000 lekë bashkia dhe 40,000 lekë hendek financiar)	75,000 lekë (nga të cilat 35,000 lekë bashkia dhe 40,000 lekë hendek financiar)
III.2.5. Aktivitete të fokusuara veçanërisht te djemtë dhe burrat (takime, sesione mbi maskilizmin toksik, aktivitete në shkolla, etj.).	Sektori i Kujdesit Social	Sektori i Arsimit dhe Sporteve, anëtarëte MKR , Ministritë e linjës, OJF, organizatat ndërkombëtare	2025 2027	Të paktën 2 aktivitetet në vit. Numri i djemve dhe burrave të përfshirë ndarë sipas moshës, vendbanimit, etj.	132,660 lekë (nga të cilat 54,660 lekë bashkia dhe 78,000 lekë hendek financiar)	132,660 lekë (nga të cilat 54,660 lekë bashkia dhe 78,000 lekë hendek financiar)	132,660 lekë (nga të cilat 54,660 lekë bashkia dhe 78,000 lekë hendek financiar)
III.2.6. Aktivitete informuese mbi trafikimin e qenieve njerëzore	Sektori i Kujdesit Social	ZVA, NJA, Shkollat, OJF, organizatat ndërkombëtare	2025 2027	Çdo vit gjatë muajit përkatës	100,000 lekë (bashkia)	50,000 lekë (bashkia)	50,000 iekë (bashkia)
III.2.7. Organizimi i aktiviteteve mbi barazinë gjinore dhefuqizimin e grave në kuadërtë Ditës (javës) Ndërkombëtare të Gruas	Sektori i Kujdesit Social	NJA, ZVA, Shkollat, OJF, organizatat ndërkombëtare	2026 2027	1 aktivitet në vit)	N/a	50,000 lekë (bashkia)	50,000 lekë (bashkia)
III.2.8. Angazhimi i medias lokale për të promovuar modele pozitive të grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve që angazhohen për barazinë gjinore	Koordinator i Projekteve të BE-së	Sektori i Kujdesit Social, Media Lokale	2025 2027	1 kronikë në vit	20,000 lekë (bashkia)	20,000 lekë (bashkia)	20,000 lekë (bashkia)

						hendek financiar)	hendek financiar)
III.2.13. Shtimi i numrit të inspektimeve për zbatimin në mënyrën e duhur dhe përfshirjen e perspektivës gjinore në programet e zhvillimit në kopshte dhe shkolla.	Sektori i Arsimit Parashkollor	Kopshtet, shkollat	2026 2027	Të paktën 2 inspektime në vit	N/a	42,915 lekë (bashkia)	42,915 lekë (bashkia)
III.2.14. Emërimi i mësueseve / mësuesve ndihmës në 6 kopshtet më të mëdha	Sektori i Arsimit Parashkollor	Sektori i Buxhetit	2026 2027	Numri i mësues/e të emëruar/a gjithsej)	N/a	1,416,000 lekë (bashkia)	1,416,000 lekë (bashkia)
III.2.15. Trajnimi i mësueseve/mësuesve ndihmës nga qendra e zhvillimit	Qendra e Zhvillimit	Sektori i Arsimit Parashkollor	2026 — 2027	1 trajnim në vit Numri i personave të trajnuar ndarë sipas seksit, profesionit, etj.	N/a	31,000 lekë (nga të cilat 6,000 lekë bashkia dhe 25,000 lekë hendek financiar)	31,000 lekë (nga të cilat 6,000 lekë bashkia dhe 25,000 lekë hendek financiar)
III.2.16. Trajnimi i stafit të Bashkisë dhe NJA- ve për ofrimin e sesioneve informuese mbi prindërimin pozitiv	Sektori i Kujdesit Social	OJF, organizatat ndërkombëtare	2026 2027	1 trajnim në vit Numri i personave të trajnuar ndarë sipas seksit, profesionit, etj.	N/a	10,000 lekë (hendek financiar)	10,000 lekë (hendek financiar)
III.2.17. Takime informuese me nëna dhe baballarë mbi prindërimin pozitiv	Qendra e Zhvillimit	NJ A, OJF, organizatat ndërkombëtare	2026 2027	2 takime në vit Numri i prindërve të përfshirë ndarë sipas seksit, moshës, vendbanimit, etj.	N/a	14,166 lekë (bashkia)	14,166 lekë (bashkia)
Objektivi specifik:	**III.3. Fuqizimi i grave, të rejave dhe të rinjve për ndërtimin e komuniteteve të sigurta, përmes promovimit të Agjendës "Gruaja, Paqja dhe Siguria" dhe Agjendës "Rinia, Paqja dhe Siguria".**						
Treguesit:					**Baseline: (2025)**	**Target: (2027)**	**MONITORIMI**

III.3.4. Shtimi i elementëve të sigurisë në hapësirat publike dhe rrugët e planifikuara për rikonstruksion (ndricim i plotë, kamera të sigurisë, tabela dhe sinjalistika, etj).	Sektori i Mirëmbajtjes së Institucionev e dhe Ndricimit Rrugor	Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit	2025 2027	Elementët e sigurisë të shtuar, sipas investimeve që bëhen në hapësirat publike	Kosto do përllogaritet në zërin e investimeve të përvitshme	Kosto do përllogaritet në zërin e investimeve të përvitshme	Kosto do përllogaritet në zërin e investimeve të përvitshme

Fusha e ndërhyrjes (Objektivi strategjik):	**IV. INTEGRIMI GJINOR NË POLITIKAT VENDORE.**
Rezultatet e pritshme:	IV.a. Përgjegjshmëria dhe transparenca e bashkisë mbi përmbushjen e angazhimeve publike për barazinë gjinore, e rritur ndjeshëm. IV.b. Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor i zbatuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe integrimi gjinor i reflektuar në politikat dhe planet e bashkisë.
Dokumentet kryesore që u referohemi:	- Karta Evropiane për Barazi të grave dhe burrave në jetën vendore (EU Charter for Equality) - nenet *4, 5,* 7, 8, 9. - Konventa për Eliminimin e të gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAË) - neni 3. - Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit (BDPfA) - fusha kritike 8. - Konventa e KE për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) - nenet 6, 8. - Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore i BE (EU GAP III) - shtyllat 1, 5. - Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore (SKBGJ) 2021 - 2030 - objektivi specifik IV.3.
Objektivi specifik:	**IV.I. Rritja e përgjegjshmërisë dhe transparencës së bashkisë në përmbushjen e angazhimeve publike për barazinë gjinore.**

Treguesit:	**Baseline: (2025)**	**Target: (2027)**	**MONITORIMI**
IV.I.a. Numri i raporteve të monitorimit të zbatimit të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore, të miratuara në Këshillin Bashkiak dhe të publikuara në faqen zyrtare të bashkisë dhe në Atlasin e Nënshkruesve të Kartës Evropiane për Barazi, të Këshillit të Bashkive dhe Rajoneve të Evropës (KBRE).	0	2 (1 çdo vit)	Komisioni për Barazi Gjinore në nivel bashkie / Grupi i Monitorimit të PVVBGJ; Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Përfshirjes Sociale, si dhe anëtaret/anëtarët e Këshillit Bashkiak.

IV. 1.5. Shtimi i një seksioni (apo faqeje të dedikuar) për barazinë gjinore në faqen e internetit të bashkisë dhe përditësimi rregullisht i informacionit në këtë faqe të dedikuar për BGJ	Koordinator i projekteve me BE-në	Sektori i Kujdesit Social Personi përgjegjës për TI	2025 2027	Seksioni i shtuar dhe përditësuar me informacione rregullisht	54,000 lekë (bashkia)	21,000 lekë (bashkia)	21,000 lekë (bashkia)
IV.1.6. Trajnimi i stafit të bashkisë mbi monitorimin e brendshëm të zbatimit të PVVBGJ-së përmes mbledhjes së të dhënave dhe përdorimit të një formati raportimi të unifikuar	Sektori i Burimeve Njerëzore	Sektori i Kujdesit Social, organizatat ndërkombëtar e	2025 2026	1 trajnim dhe sesione mentorimi sipas nevojës	78,000 lekë (nga të cilat 18,000 lekë bashkia dhe 60,000 lekë hendek financiar)	78,000 lekë (nga të cilat 18,000 lekë bashkia dhe 60,000 lekë hendek financiar)	N/a
IV.1.7. Hartimi i raporteve periodike vjetore mbi progresin në zbatimin e PVVBGJ	Sektori i Kujdesit Social	Të gjitha drejtoritë në bashki përgjegjëse për zbatimin e PVVBGJ, institucionet publike, OJF, organizatat ndërkombëtar e	2025 2027	Një raport në vit	19,550 lekë (bashkia)	19,550 lekë (bashkia)	19,550 lekë (bashkia)

Objektivi specifik:	**IV.2. Zbatimi i detyrimeve për integrimin gjinor dhe buxhetimin e përgjigjshëm gjinor në nivel vendor.**		
Treguesit:	**Baseline: (2025)**	**Target: (2027)**	**MONITORIMI**
IV.2.a. Numri i programeve buxhetore të analizuara nën këndvështrimin gjinor.	0	1	Komisioni për Barazi Gjinore në nivel bashkie / Grupi i Monitorimit të PVVBGJ;